KRONIKË E ZEZË

Policia publikon videon kur grabitësit gjuajtën me armë ndaj tyre në Ferizaj



Një i vdekur, katër të lënduar në një aksident në rrugën Prishtinë - Ferizaj

I mituri raporton se ia vodhën 85 euro duke e kërcënuar me thikë

U ngrihet aktakuzë dy personave për keqpërdorim në prokurim dhe falsifikim të dokumenteve

Tentohet të grabiten tri bankomate, grabitësit gjuajnë me armë Policinë

Tentoi ta godiste me veturë një person të komunitetit LGBTQ+, kërkohet paraburgim ndaj të dyshuarit

Dy vajza raportohen se janë zhdukur në Prishtinë

Arrestohet një 22-vjeçar serb i Kosovës, i konfiskohet një pistoletë

3 nëntor 2023, 16:22

Shpërndaje në

Policia e Kosovës ka publikuar videon kur grabitësit kanë gjuajtur me armë ndaj tyre në Ferizaj gjatë orëve të para të së premtes. Siç ka thënë Policia, cak i grabitësve ishin tre bankomatet që ishin skaj rrugës ku ndodhi incidenti, por sipas autoriteteve, falë intervenimit të shpejtë është parandaluar grabitja.

Policia ka thënë se me të arritur në vendngjarje, të dyshuarit kanë filluar të gjuajnë me armë të gjata ndaj tyre. Policia u kundërpërgjigj, por siç thuhet në njoftim, të dyshuarit arritën të iknin me një veturë karavan në drejtim të panjohur. Dyshohet se në veturë ishin katër persona, që ishin të pajisur me armë të gjata.

Grabitësit kishin arritur që njërin bankomat ta shpërthenin me eksploziv, por pa arritur qëllimin final.

Rasti është cilësuar si "Vrasje e mbetur në tentativë", "Grabitje e armatosur e mbetur në tentativë" dhe "Armëmbajtje pa leje".

Policia ka kërkuar ndihmë nëse dikush ka informacion për personat e dyshuar duke njoftuar në aplikacionin "Lajmëro Policinë", apo në numrat 192, 0290/326-250 & 0290/322-406.

Njoftimi i plotë:

Me datën 03.11.2023 rreth orës 04:50 kemi pranuar një informacion se në rrugën magjistrale Ferizaj-Prishtinë në afërsi të pikës së karburantit "Hib Petrol" në Ferizaj ishte një grabitje e armatosur në proces nga persona të panjohur.

Patrulla e policisë me të arritur në vendin e ngjarjes, të dyshuarit kanë filluar të shtënë me armë zjarri në drejtim të veturës së policisë, duke dëmtuar në masë të madhe veturën zyrtare, mirëpo dy policët që ishin në veturë nuk kanë pësuar ndonjë lëndim trupor, ndërsa në shkëmbim të armëve të zjarrit i janë përgjigjur edhe zyrtarët policor dhe të dyshuarit janë larguar nga vendi i ngjarjes me një veturë karavan, ngjyrë e zezë, në drejtim të panjohur dhe në veturë dyshohet se ishin 4 persona me armë të gjata.

Ekipe të policisë menjëherë kanë dalë në vendin e ngjarjes në asistim të patrullës së policisë, e më pas në vend të ngjarjes kanë dalë hetuesit dhe krimteknikët rajonal, të cilët nën autorizim të prokurorit kujdestar, i cili edhe ai ka dalë në vendin e ngjarjes, i kanë nisur hetimet.

Gjithashtu në vendin e ngjarjes ka dalë edhe Njësia e Deminimit e Policisë së Kosovës.

Nga hetimet e para hetuesit rajonal kanë mësuar se cak i personave të maskuar ishin 3 bankomatet që gjenden skaj rrugës magjistrale në parkingun e qendrës tregtare " Superviva" në Ferizaj.

Personat e maskuar fillimisht me një mjet plasës kanë shpërthyer njërin bankomat, ndërsa kanë dëmtuar edhe dy bankomatët tjerë, mirëpo falë intervenimit të shpejtë të policisë, posa arrinë patrulla e parë policore, të dyshuarit fillojnë të shtënë në drejtim të veturës së policisë dhe të largohen nga vendi i ngjarjes.

Nga të dyshuarit në këtë rast janë përdorur mjet eksplozivë në bankomat dhe pushkë automatike në drejtim të policëve në veturën e policisë.

Hetuesit rajonal pasi kanë kryer egzaminimet në vendin e ngjarjes, në bashkëpunim edhe me njësitet tjera të policisë rajonale janë në kërkim të personave të dyshuar.

Rasti është cilësuar " Vrasje e mbetur në tentativë, grabitje e armatosur e mbetur në tentativë dhe armëmbajtje pa leje.

Ndërsa, ftojmë qytetarët që të bashkëpunojnë më policinë.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

Taboola Feed

WARNING
Your protection from viruses is expiring!
Block viruses and malware
The Highest Rated Protection
Keeps devices running fast
Activate Protection
McAfee

McAfee License Renewal Notice
Click Here To Activate Your McAfee Antivirus
McAfee.com | Sponsored
Click Here

Knee Pain After 50? Do This 2 Times a Day (Watch)
New Nutrition Secrets | Sponsored

Easy Business Management Softwares (Take a Look)
CommonSearches | Sponsored

5 Reasons Why Homeowners Over 60 Should Use A Lifetime Mortgage
Join the growing numbers using the value of their home to fund their retirement wishes.
Responsible Life | Sponsored
Learn More

Saturday News! Support NHS Charities Together, McLaren to be…
A builder won a E3M townhouse in the Omaze Draw. You could be next – enter to …
Omaze | Sponsored
Try Now

Discover the fully electric Volvo EX30
The new Volvo EX30. Our smallest ever SUV, packed with big car technology.
Volvo Cars | Sponsored
Learn More

TË TJERA

31-vjeçari në Pejë arrestohet për shpërndarje të produkteve të dëmshme mjekësore

Një person gjendet i vdekur në një objekt biznesi në Malishevë

Konfiskohen bizhuteri argjendi në vlerë mijëra euro në kufi

Policia me aksion në katër rajona, konfiskon armë e fishekë

Datenschutz

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe internetit a mediumi tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!